

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"AFA LEGAL CONSULTING SHPK"**

**THEMELIMI
DATA E THEMELIMIT, EMRI, THEMELUESIT**

**SOT ME DATE 26.11.2021 NE THEMELUESIT KEMI KRIJUAR NJE
SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR ME EMRIN "AFA LEGAL
CONSULTING SHPK"**

THEMELUESIT E SHOQËRISË "AFA LEGAL CONSULTING" SH.P.K JANË :

**Fabian Topollari, i biri i Sokolit e dtl 20.08.1986, lindur në Gramsh, e banues ne Rr:
" Hamdi Sina" Tirane, i identifikuar sipas Leternjoftimit ID me nr 032648643**

**Amantja Patozi, e bija e Bujarit e dtl 12.11.1984, lindur në Tirane e banues ne
Tirane, i identifikuar sipas Leternjoftimit ID me nr I461120720**

miratojne kete statut me dispozitat e meposhtme:

KAPITULLI I

Legjislacioni

Neni 1

Shoqeria "AFA LEGAL CONSULTING" SH.P.K: qe ne vazhdim shkurtimisht do te quhet "Shoqeria" eshte krijuar ne baze te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

Forma

Neni 2

Forma juridike e shoqerise eshte ajo e "shoqerise me pergjegjesi te kufizuar" prandaj pergjegjesia e ortakeve eshte e kufizuar deri ne shumen e pjeses se zoteruar nga kapitali themeltar.

KAPITULLI II

Emertimi,

Neni 3

Emertimi i shoqerise eshte: "AFA LEGAL CONSULTING" SH.P.K:

Selia

Neni 4

Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane, Rr. "Hamdi Sina", Ndertesa 20, Hyrja 2, Apartamenti 22, Farke. Ne baze te ligjit shoqeria mund te hape apo krijoje seli dytesore, dege, filiale, agjenci, zyra perfaqesie si ne Shqiperi, ashtu edhe jashte saj.

Kohezgjatja

Neni 5

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte e pacaktuar. Kjo periudhe mund te nderpritet vetem me vendimin e asamblese se ortakeve ose per shkaqe te tjera te parashikuara nga ligji.

KAPITULLI III

Objekti

Neni 6

Objekt i aktivitetit tregtar te shoqerise do te jete:

- Konsulence dhe sherbime ligjore per persona fizike, subjekte juridik privat dhe shteteror;
- Perfaqesim te personave fizik dhe juridik ne te gjitha llojet e ceshtjeve civile, penale administrative, ne te gjitha shkallet e gjyqesorit ne Republiken e Shqiperise dhe pranë cdo institucioni te administrates publike, perfshi dhe hartimin e kerkesave dhe perfaqesimin e subjkteve ne Gjykatën Kushtetuese te Republikes se Shqiperise.
- Konsulencë juridike dhe ekonomike për investitorë të ndryshëm

- Ndjekje e procedurave administrative, juridike dhe burokratike të personave të ndryshëm në të gjitha institucionet e administratës publike dhe për të gjitha llojet e procedurave burokratike administrative sic janë lejet apo licensat, regjistrim prone, si dhe cdo procedurë tjetër në raport me administratën publike
- Ndjekje dhe aplikim për llogari të personave të ndryshëm të të gjithë procedurave të prokurimit publik.
- Hartim projektesh social kulturore dhe konkurim në cdo institucion publik apo privat për subvencionimin e këtyre projekteve
- Ndërmjetësim, për shitblerje dhënie me qira, të pronave të paluajtshme.
- Ndërmjetësim për lidhje kontratash midis subjekteve.
- Ndermjetesime me pajtim;
- Kryerja e cdo veprimi te lejuar nga ligji per zbatimin e kontratave te porosive ne favor te klienteve te shoqerise.

KAPITULLI IV

Kapitali Themeltar

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte percaktuar ne shumen 10.000 (dhjete mije) Leke. Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme :


Ortaku themelues **Fabian Topollari**: Zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 50 000 (pesedhete mijë) leke qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Ortaku themelues **Amantja Patozi**: Zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 50 000 (pesedhete mijë) leke qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 8

Zmadhimi i kapitalit

Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te behet me vendimin e asamblese se ortakeve. Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te behet me derdhje ne para ose me kontribute ne natyre, e ne kete rast keto kontribute duhet te shoqerohen me nje raport vleresimi tekniko-financiar te kryer nga nje ekspert i vleresimit te kontributeve, te emeruar nga Ortaket e shoqerise dhe qe duhet t'i bashkelidhet vendimit te asamblese se ortakeve.




Neni 9

Zvogelimi i kapitalit

Zvogelimi i kapitalit themeltar mund te behet me vendim te asamblese se ortakeve, me propozim te administratorit, vetem ne rastin kur shoqeria mund te pesoje humbje te tilla qe e bejne te domosdoshem kete zvogelim.

Kapitali themeltar nuk mund te jete me i vogel se vlera minimale e caktuar me ligj, ne rast te kundert shoqeria detyrohet te ndryshoje formen juridike ose te prishet.

Neni 10

Transferimi i pjeseve te kapitalit

Pjeset e kapitalit themeltar jane te transferueshme ne rruge trashegimie per shkak vdekje.

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e Asamblese se Ortakeve sipas dispozitave ligjore per kete qellim.

KAPITULLI V

Ortaket e Shoqerise

Neni 11

Asambleja e Ortakeve

Asambleja e Ortakeve te shoqerise luan rolin dhe ka kompetencat qe ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" ia njej Asamblese se Ortakeve ne shoqerite e kesaj forme te themeluara nga disa ortake.

Vendimet e asamblese se ortakeve shenohen ne nje regjister qe mbahet ne seline e shoqerise.

Asambleja e Ortakeve brenda tre muajve nga dita e mbylljes se vitit financiar miraton raportin e administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore, nese eshte e nevojshme pas raportit te eksperteve kontabel te autorizuar, te hartuara dhe paraqitura nga administratori.

Neni 12

Ne vendimet qe duhet te mbaje Asambleja e zakonshme apo e jashtezakonshme do te zbatohen keto rregulla:

Asambleja e Ortakeve mund te mbahet qofte ne ambjentet e selise se shoqerise apo ne vende te tjera duke njoftuar ortakun me leter rekomande te pakten 15 dite perpara

mbledhjes se asamblese. Ne kete leter njoftohet rendi i dites dhe gjithashtu mund te perfshihet edhe data e mbledhjes se dyte ne rast se e para anullohet.

Lajmërimi bëhet nga administratori ose, në mungesë të tij, nga eksperti kontabël i autorizuar, po qe se ka të tillë.

Asambleja e zakonshme duhet te mblidhet te pakten njehere ne vit, brenda 4 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 13

Ne mbledhjen e asamblese mund te marrin pjese te gjithe personat qe rezultojne te regjistruar ne librin e ortakeve deri ne daten e mbledhjes. Secili prej ortakeve ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Nje ortak mund te perfaqesohet edhe nga nje person i trete joortak i pajisur me prokure.

Neni 14

Ne mbledhjet e asamblese se zakonshme dhe te jashtezakonshme vendimet merren me shumice te thjeshte. Vendimet e asamblese duhet te pasqyrohen nga proceverbalet e nenshkuara nga Administratori dhe Sekretari apo nga Noteri.

KAPITULLI VI

Administrimi i shoqerise

Neni 15

Emerimi i administratorit

Administrator i shoqerise do te jete ortaku **Fabian Topollari**, i biri i Sokolit e dtl 20.08.1986, lindur në Gramsh, e banues ne Rr: "Hamdi Sina" Tirane, i identifikuar sipas Leternjoftimit ID me nr 032648643

Si rregull, shoqeria do te administrohet nga nje administrator, i cili mund te zgjidhet brenda ose jashte bashkesise se ortakeve.

Emerimi i administratorit behet me shumice te thjeshte. Ai zgjidhet per nje periudhe tre vjecare dhe eshte i rizgjedhshem.

Veprimtaria e perditshme e shoqerise drejtohet nga administratori, i cili per realizimin e qellimeve te shoqerise ka te drejte t'a perfaqesoje ate dhe ne emer te saj te paraqitet para te gjitha organeve e institucioneve shteterore apo private, te lidhe kontrata si dhe te paraqitet perpara gjykatave te te gjitha shkalleve per mbrojtjen e interesave te shoqerise. Administratori ka te drejte qe me prokure te posacme te autorizojte dhe jape

tagrat e nevojshme personave te ndryshem te specializuar ne fusha te ndryshme, gjithmone per mbrojtjen e interesave te shoqerise.

Neni 16

Administratori eshte pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit ose per faje te kryera dhe deme te shkaktuara gjate administrimit te tij.

Neni 17

Administratorit mund t'i atribuohen shperblime dhe/ose paga te percaktuara nga Asambleja e Ortakeve. Administratori eshte i ngarkuar me rimbursimin e shpenzimeve te kryera per arsye te detyres se tyre, te cilat nuk mbulohen drejtperdrejt nga shoqeria.

KAPITULLI VII

Te ndryshme

Neni 18

Miratimi i llogarive

Administratori brenda tre muajve nga dita e mbylljes se vitit financiar harton dhe i paraqet Asamblese se Ortakeve per miratim, raportin e administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore.

Ortaket kane te drejte te marrin ne cdo kohe dhe kontrolloje dokumentat e mesiperme, per tre vitet e fundit financiare, si dhe mund te ndihmohen nga nje ekspert i zgjedhur prej tyre, i cili i nenshtrohet detyrimit per te ruajtur sekretin profesional.

Neni 19

Veprimtaria dhe viti fiskal i shoqerise mbyllet sipas Ligjit per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise.

Neni 20

Nga fitimi i realizuar gjate vitit finaciar, pasi te jene zbritur te gjitha shpenzimet dhe po te jete nevoja edhe humbjet e vitit te meparshem, lihet menjane nje shume me vlere jo me pak se 5% e fitimit, e cila nevojitet per formimin e fondit rezerve qe quhet "rezerva e domosdoshme", derisa kjo rezerve te arrije te pakten sa 1/10 e kapitalit themeltar. Pjesa tjeter e fitimit perdoret sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve.

Neni 21

Te gjithë dokumentet e shoqërisë, përfshirë vendimet e Administratoreve dhe ato të Asamblese së Ortakëve duhet të hartohen në gjuhën shqipe.

Neni 22

Ortakët në çdo kohë mund të vendosin prishjen e shoqërisë, në vartësi të gjendjes ekonomiko-financiare apo edhe shkaqëve të tjera që atyre mund t'u duken të arsyeshme, prishje e cila detyrimisht sjell një likuidim që do të bëhet sipas procedurave ligjore për likuidimin, të përcaktuara në ligjin "Për Tregtë dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 23

Për çfarë nuk është parashikuar në këtë statut referimi do të bëhet në dispozitat ligjore që rregullojnë këto marrëdhënie juridike.


Për konfliktet të cilat nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, palët kanë të drejtë të drejtohen në gjykatën kompetente.

Statuti hartohet në tre ekzemplare origjinale në gjuhën Shqipe, një prej të cilëve depozitohet në QKB nga Asambleja e Ortakëve.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"AFA LEGAL CONSULTING SHPK"

Fabian Topollari



Amantja Patozi

